



POROSI
TË PROFETIT MUHAMED
(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)
PËR EBU DHERRIN
(Allahu qoftë i kënaqur me të!)

Tiranë, 2023

Titulli i librit: **Porosi të Profetit Muhamed**
(*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi
familjen e tij!*) për **Ebu Dherrin** (*Allahu qoftë i
kënaqur me të!*)

I tuboi dhe i përktheu: **Haxhi Sheh**

Vullnet Merja

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Korrekttoi: **Vjollca Karaj**

Përkujdesja kompjuterike: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: Shoqata "Flladi"- Tiranë, 2023

**Me emrin e Allahut, të
Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!**

Falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur!

Es Selamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu! - *Paqja, mëshira dhe begatitë e Allahut qofshin mbi ju!*

KUSH ËSHTË EBU DHERR EL GIFARIJI?

Emri i plotë: **Xhundeb ibn Xhunadetu ibn Sufjan**

Emri i dytë: **Ebu Dherr**

Mbiemri: **El Gifarij**

Data e lindjes: **20 vjet para se Profetit Muhamed t'i zbriste Profetësia**

Vendlindja dhe vendbanimet: **Mekë, Medine, Sham dhe Err Rrebdhetu**

Prejardhja: **Muhaxhir**

Data e vdekjes: **Muaji Dhul Hixhe, viti 32 hixhri. Ka vdekur në kohën e kalifatit të**

**Othman ibn Afanit, në Err Rrebdhetu,
pasi Othmani e dëboi në Rrebdhetu.**

**Vendvarrimi: Rrebdhetu, Medine
Munauereh**

Fisi Gafar ka qenë prej fiseve politeiste arabe. Ai jetonte në zonën e Medines së ndritur (Jatrib), ku kalonin karvanët tregtarë të Mekës.

Personat e fisit Gafar adhuronin idhullin Menata dhe besonin se në dorën e tij është caktimi, vendimi dhe fati. Ata shkonin te ky idhull dhe prisnin kurban për të.

Një ditë prej ditësh, një djalë i ri e i varfër prej fisit Gafar shkoi te idhulli Menata, për t'i dërguar atij qumësht. Kur e la qumështin pranë tij, filloi ta shikonte, por Menata nuk lëvizi dhe nuk piu qumësht. Djali rrinte dhe e shikonte. Në ato momente, aty pranë kaloi një dhëlpër dhe nuk e ndjeu praninë e Xhundebit. Ajo e piu qumështin. Nuk mjaftoi vetëm me kaq. Ajo urinoi te veshi i Menatas dhe ai nuk reagoi.

Djali qeshi dhe filloi të tallej me idhullin dhe me veten e tij, sepse ai adhuronte një gur shurdh, që as kuptonte e as perceptonte gjë.

Gjatë kthimit, Xhundebit iu kujtuan fjalët e Kajs ibn Saidehit, që i dëgjoi një ditë kur po ecte në tregun Akadh, në qytetin e

Mekës. Midis të tjerash ai kishte thënë: “O njerëz, dëgjoni dhe kuptoni! Kush jeton, vdes dhe kush vdes, ikën. Ai që do të vijë, do të vijë. Natë është e errët e qielli me yje. Përse unë po shoh që njerëzit që ikin, nuk kthehen?! Vallë, a ju pëlqeu vendi dhe qëndruan?! Apo u lanë atje dhe fjetën?!”

Xhundebi vështroi qiellin e kthjellët blu, shkretëtirën e gjatë me kodrat e rërën e saj dhe kujtoi se çfarë bëri dhelpra me idhullin. Aty besoi se kjo botë e madhe ka një Zot më të madh se Menata, Hubeli, Lati dhe më i madh se çdo idhull. Që nga ajo kohë, Xhundeb ibn Xhunadetu drejtohej me zemrën e tij kah qielli e toka.

Ithtarët e Librit thoshin se një profet i ri do të vijë në kohën e tyre. Fiset arabe e përhapnin këtë lajm. Ata që talleshin me idhujt, ishin të përmalluar ta shikonin atë profet të ri.

Një ditë, një burrë që po vinte nga Meka, takoi Xhundebin.

- Në Mekë ndodhet një burrë, që thotë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe thotë se është profet, - i tha burri Xhundebit.

- Nga cili fis është ai? - e pyeti Xhundebi.

- Nga fisi Kurejsh.

- Nga cila degë e fisit Kurejsh?
- Nga fisi Hashimi.
- Çfarë bënë kurejshët?
- E përgënjeshtroan dhe thanë se ai është magjistar dhe i çmendur.

Burri u largua dhe Xhundebi ra në mendime.

Pastaj vendosi të dërgojë vëllanë e tij, Enisin, në Mekë, që t'i sillte lajme nga profeti i ri.

Enisi u nis dhe përshkoi qindra kilometra, deri sa arriti në Mekë. Ai nuk

qëndroi shumë në Mekë dhe u kthye shpejt, që të lajmëronte të vëllanë.

- Unë pashë një burrë që urdhëronte për mirësi, ndalonte të këqijat dhe ftonte në adhurimin e Allahut të vetëm, - i tha Enisi. - E pashë atë duke u falur në Qabe. Në krah të tij ishte një djalë, që quhej Ali ibn ebu Talibi, që ishte djali i xhaxhait të tij. Pas tyre ishte një grua, bashkëshortja e Profetit, Hatixheja.

- Çfarë pe tjetër? - e pyeti Xhundebi vëllanë e tij.

- Këto pashë, - iu përgjigj Enisi. - Nuk guxova të afrohem te ai, ngaqë kisha frikë nga paria kurejshe.

DREJT MEKËS

Xhundebi nuk u bind nga ato që dëgjo. Ai u nis vetë për në Mekë, që të njihnte Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Mbërriti atje në perëndim të diellit. Bëri tauaf rreth Qabes, pastaj u ul në një qoshe të saj, që të çlodhej dhe filloi të mendojë se si ta takojë Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ra nata dhe Qabeja u boshatis nga

njerëzit. Në ato momente, një djalë hyri në Xhaminë e Shenjtë dhe filloi të bëjë tauaf rreth Qabes, me frikë e respekt të madh. Djali pa se një person i huaj ishte afër tij. Iu afrua atij.

- Mos je i huaj? - e pyeti me mirësjellje.

- Po, - iu përgjigj Xhundebi.

- Çohu dhe eja me mua në shtëpinë time, - tha djali.

Xhundebi e falënderoi djalin dhe filloi ta ndjekë atë në heshtje.

Në mëngjes, Xhundebi u nda nga djali dhe shkoi te pushi i ujit Zemzem, me

shpresën se do të njihej me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kaluan orë dhe Xhundebi vështronte e priste, që të errësohej.

TAKIMI

Natën tjetër, djali i ri shkoi në Qabe dhe bëri tauaf. Aty pa përsëri burrin që takoi një natë më parë, të ulur në të njëjtin vend, ku ishte ulur natën e parë. Djali iu afrua.

- Çuditë me ty, - i tha djali. - A nuk ke shtëpi?

- Jo nuk kam, - iu përgjigj Xhundebi.

- Eja me mua në shtëpinë time.

Xhundebi u ngrit dhe e ndoqi në heshtje djalin.

- Të shoh që po mendohesh. Çfarë nevoje ke? – e pyeti djali.

- Nëse nuk tregon, do të ta them se çfarë nevoje kam, - iu përgjigj Xhundebi.

Djali i tha se nuk do të tregonte asgjë për të, inshallah.

Kur Xhundebi dëgjoji fjalën “inshallah”, u qetësua.

- Kam dëgjuar për ardhjen e një profeti në Mekë dhe dëshiroj ta takoj atë, - i tha Xhundebi me zë të ulët.

- Allahu të ka udhëzuar, - i tha djali duke i buzëqeshur. - Do të të çoj unë te shtëpia e tij. Më ndiq nga larg. Nëse shikoj dikë, që mund të të bëjë keq ty, do të ndaloj dhe do të hiqem sikur po rregulloj sandalen time. Ti mos ndalo, por vazhdo rrugën tënde.

Djali u nis për te shtëpia e zotërisë sonë, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Xhundebi e ndoqi atë, deri sa mbërritën.

BESIMI

Xhundebi hyri në shtëpinë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili qëndronte para njerëzve.

- Nga të kemi? - e pyeti Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- Jam nga fisi Gafar, - iu përgjigj Xhundebi.

- Çfarë nevoje ke? – e pyeti Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përsëri.

- Më njih me Islamin.

- Islami është të dëshmosh se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut.

- Po pastaj?

- Të heqësh dorë nga të këqijat, të shëmtuarat e të ndytat, të ndjekësh moralet e mira, të braktisësh adhurimin e idhujve dhe të adhurosh Allahun e vetëm e të pashoq, të mos shpërdorosh e as të bësh padrejtësi.

Xhundebi u mbush me besim për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

- Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Allahut, - tha Xhundebi. - Jam i kënaqur që kam për Zot Allahun dhe ty Profet.

Në ato momente lindi një personalitet i ri, personaliteti i shokut të ngushtë, Ebu Dherr el Gifari, Xhundeb ibn Xhunadetu, i cili u ngrit dhe tha me entuziazëm: “Betohem në Atë që të dërgoi ty, këtë do ta them me zë shumë të lartë” .

Para se Ebu Dherri të largohej nga shtëpia, e pyeti Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Kush është ai djali që më solli te ti?”

- Ai është djali i xhaxhait tim, Aliu, - i tha Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me krenari. - O Ebu Dherr! Mbaje të fshehtë këtë gjë dhe kthehu në vendin tënd!

Ebu Dherri e kuptoi se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte frikë se mos kurejshët hakmerreshin, duke e lënduar atë.

- Betohem në Atë që të dërgoi ty profet, - i tha Ebu Dherri. - Unë do ta them me zë të lartë këtë dëshmi në mes të kurejshëve e ata le të bëjnë çfarë të duan.

Në mëngjes, Ebu Dherri u nis për te Shtëpia e Allahut, Qabja. Idhujt prej guri ishin në vendet e tyre dhe nuk lëviznin. Ebu Dherri çante rrugën drejt tyre. Tiranët kurejshë ishin ulur, duke biseduar për çështjen e fesë së re.

Në ato momente u dëgjua britma guximtare: “O kurejshë! Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Allahut!”

Idhujt dhe zemrat e kurejshëve u lëkundën nga britma e tij. Kurejshët bërtitën: “Kush është ai që i shan zotat tanë?”

Ata vrapuan drejt tij dhe e rrahën aq shumë, sa i ra të fikët dhe gjaku i rridhte si lumë.

Aty ndërhyri Abasi, xhaxhai i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke e shpëtuar me fjalët që u tha kurejshëve: “Mjerë ju o kurejsh! Si po vrisni një burrë prej fisit Gafar, kur karvanët tuaj kalojnë nga territori i këtij fisi?”

Ebu Dherri u zgjua. Shkoi te burimi i Zemzemit dhe lau gjakun nga trupi i tij. Përsëri ai donte të sfidonte kurejshët me besimin e tij. Për këtë ai shkoi në Qabe dhe bërtiti: “Unë dëshmoj se nuk ka Zot tjetër

përveç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i Allahut!”

Kurejshët e sulmuan si ujqërit, e rrahën deri sa i ra të fikët. Përsëri atë e shpëtoi Abasi.

KTHIMI

Ebu Dberri shkoi te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili, kur e pa në atë gjendje, i erdhi keq për të.

- Kthehu te populli yt dhe ftoj ata në Islam, - i tha Profeti Muhamed.

- O i Dërguari i Allahut, unë do të shkoj te populli im dhe do t'i ftoj ata në

Islam, por kurrë nuk do ta harroj atë që më bënë kurejshët, - i tha Ebu Dherri.

Ebu Dherri u kthye te fisi i tij dhe filloi ta ftojë fisin e tij në Islam. Islamin e pranoi vëllai i tij, Enisi, nëna e tij dhe gjysma e fisit. Kurse gjysma tjetër thanë se do ta pranonin Islamin, kur të vinte Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

EMIGRIMI (Hixhreti)

Ditët, muajt dhe vitet kalonin. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) emigroi nga Meka në Medine. Lajmi mbërriti te Ebu Dherri. Ai, së bashku me fisin e tij, doli në rrugë për të pritur Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Ai e pa Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e*

tij!) nga larg, të hipur mbi një deve. Ebu Dherri nxitoi drejt tij, e kapi devenë nga kapistra dhe i foli Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

- O i Dërguari i Allahut! - foli ai. - Nëna ime, vëllai im dhe shumë persona të fisit e pranuan Islamin.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u lumturua, kur pa gjithë ata njerëz, që po e prisnin.

- O i Dërguari i Allahut, - i foli njëri nga banorët. - Ebu Dherri na mësoi ato që ti ia mësove atij dhe e pranuan Islamin. Ai na udhëzoi se ti je i Dërguari i Allahut.

Edhe pjesa tjetër e fisit Gifar e pranoi Islamin. Më pas erdhi një fis tjetër me emrin Eslem, që jetonte pranë fisit Gifar dhe e pranoi Islamin, duke dëshmuar se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se ti je i Dërguari i Allahut.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u prek shumë nga këto fjalë dhe tha: “Allahu e faltë fisin Gifar dhe i dhëntë mirësi fisit Eslem”.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vazhdoi rrugën për në Medine dhe Ebu Dherri e shoqëroi deri në një pjesë të rrugës dhe u kthye.

Kur Ebu Dherri u kthye në fisin e tij, disa prej tyre e pyetën: “A të tha ndonjë gjë i Dërguari i Allahut?

- Po. Më urdhëroi për shtatë gjëra:

1- T’i dua mjeranët dhe t’u qëndroj pranë.

2- Të shoh atë që është më poshtë se unë dhe të mos shoh atë që është më lart se unë.

3- Të mbaj lidhjet familjare, edhe nëse ata ma kthejmë shpinën.

4- Të mos i kërkoj askujt asgjë.

5- Të them të vërtetën, edhe nëse është e hidhur.

6- Të mos i trembem qortimit të qortuesit.

7- Të them sa më shumë: Nuk ka rrugëzgjdhje e as fuqi tjetër përveç fuqisë së Allahut të Lartë e Madhështor. Këto janë thesar nën Fron (Arsh).

Ebu Dherrri qëndroi në fisin e tij, duke i udhëzuar e duke i mësuar ata. Ai ishte shembulli më i mirë i besimtarit.

RRUGA DREJT TEBUKUT

Kaluan vite e vite dhe myslimanët u bënë një bashkësi (umet) e përbashkët. Ata triumfuan ndaj armiqve të tyre politeistë e jehudij dhe fiset arabe hynë në fenë e Allahut grupe-grupe.

Meqenëse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i Dërguar për mbarë njerëzit, ai dëshironte që Islami t'i kapërcente kufijtë e

Gadishullit Arabik dhe të mbulonte të gjithë botën.

Ai lajmëroi për xhihad dhe i urdhëroi myslimanët të përgatiten për shkuar në Tebuk, në veri të Gadishullit Arabik. Myslimanët u befasuan nga ky lajmërim i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për t'u përballur me shtetin më të madh në botë në atë kohë.

Munafikët, të cilit ishin grumbulluar në shtëpinë e jehudiut Suvejlem, thanë: “Herakliu do t'i mposhtë ata me ushtrinë e tij. Munafikët i frikësonin myslimanët, që të mos shkonin në Tebuk”.

Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) doli nga Medina për në Tebuk, munafikët dhe disa me zemra të sëmura dezertuan. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vendosi të caktojë zëvendës të tij në Medine djalin e xhaxhait të tij, trimin dhe sypatremburin e Islamit, Ali ibn ebu Talibin, që të shkatërronte kurthet dhe intrigat e munafikëve.

Munafikët u shqetësuan nga prania e Aliut dhe filluan të përhapnin fjalë te njerëzit se i Dërguari e la zëvendës në Medine, sepse ishte njeri i rëndomtë. Kur dëgjoji këto thënie, Aliu doli nga Medina për të ndjekur Profetin Muhamed (*Paqja e*

bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe u takua me të në El Xhurfu. Aliu e lajmëroi Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se çfarë kishin thënë munafikët.

- A është e vërtetë ajo që thanë ata? -
e pyeti Aliu.

- Munafikët gënjejnë, - i tha Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duke buzëqeshur. - Unë të lashë ty të më zëvendësosh, që të mbrosh Medinen dhe ta ruash atë prej intrigave të munafikëve. O Ali! A nuk dëshiron të jesh te unë në atë pozitë që ishte Haruni te Musai, me përjashtim se nuk ka profet pas meje?

- Po, dëshiroj o i Dërguari i Allahut! -
iu përgjigj Aliu.

Pasi dëgjoji fjalët e të Dërguarit të
Allahut, Aliu u kthye i gëzuar në Medine.

BËHU SI EBU DHERRI

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), së bashku me ushtrinë islame, që drejtonte, vazhdoi rrugën përgjatë shkretëtirës. Disa myslimanë me besim të dobët dezertuan nga ushtria dhe u kthyen në Medine. Kur Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e njoftonin se filani dezertoi dhe u kthye, ai thoshte:

“Lëreni. Nëse te ai do të ketë mirësi, do t’ju ndjekë”.

Në mesin e rrugës, një mysliman i tha Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “O i Dërguari i Allahut. Ebu Dherri u kthye mbrapsht”.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: “Lëreni. Nëse te ai do ketë mirësi, do t’ju ndjekë”.

Ushtria islame vazhdonte të ecte nëpër shkretëtirë. Ebu Dherri po udhëtonte me një gomar të lodhur e të pafuqishëm. Nga pafuqia e gomarit, pak e nga pak, ai mbeti prapa ushtrisë islame. Gjendja e

gomarit u rëndua aq shumë, sa nuk bënte asnjë hap përpara. Ebu Dherrri u ul i mërzitur dhe mendonte çfarë të bënte, të kthehej në Medine apo të ndiqte ushtrinë duke ecur në këmbë.

Ai nisi të ecë në këmbë nëpër shkretëtirën përvëluese. Pavarësisht se ushqimi dhe uji i mbaruan, ai vazhdoi ecjen në këmbë, ngaqë zemra e tij rrihte vetëm për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Atë e mori etja. Pa një burim uji. U afrua, e provoi. Uji ishte i ftohtë dhe i shijshëm. Deshi të pinte, por nuk piu dhe tha: “Unë nuk do të pi, deri sa i Dërguari i Allahut të pijë nga ky ujë. E mbushi pagurin e tij dhe vazhdoi rrugën”.

Ai eci ditë e natë, që ta arrinte ushtrinë islame.

Ushtria islame ishte ulur të pushonte, që të nesërmen të vazhdonte rrugën për në Tebuk. Kur zbardhi dita, disa myslimanë panë nga larg që një burrë po vinte drejt tyre.

- O i Dërguari i Allahut! - i thanë ata të Dërguarit të Allahut. - Një burrë po ecën vetëm.

- Ai është Ebu Dherri, - u tha Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Myslimanët po e vështronin burrin.

- Betohemi në Allah, ai qenka Ebu Dherri! - thanë ata, kur ai u afrua.

Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pa të lodhur, të rraskapitur e të etur, tha: “Sillini ujë, sepse ai është i etur”.

Ebu Dherri eci drejt Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në dorë kishte pagurin (kirben) e tij me ujë, që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të pinte nga ajo.

- O Ebu Dherr! - i foli Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi*

të dhe mbi familjen e tij!)). - Ke me vete ujë dhe nuk ke pirë?

- Po, o i Dërguari i Allahut, nëna dhe babai im u bëfshin kurban për ty! - i tha Ebu Dherrri. - Kur po vija, pashë një pellg me ujë shiu. E provova dhe ishte i shijshëm e i ftohtë. Pastaj thashë se nuk do të pi nga ky ujë, deri sa prej tij të pijë i Dërguari i Allahut.

- Allahu të mëshiroftë o Ebu Dherr! - i foli Profeti Muhamed, i prekur nga këto fjalë. - Ti do të jetosh i vetëm. Do të vdesësh i vetëm. Do të hysh në Xhenet i vetëm. Me ty do të lumturohet një popull në Irak. Ata do të marrin përsipër larjen e xhenazes

tënde, përgatitjen e saj dhe faljen e namazit të xhenazes tënde.

Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vdiq, myslimanët u hidhëruan shumë. Ebu Dherrit iu copëtua zemra. Ai ishte besniku i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Mësoi shumë hadithe nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ato hadithe ishin pishtarë ndriçues përgjatë rrugës së jetës.

Edhu Dherri besonte fort se udhëheqja (kalifati) është një e drejtë hyjnore, si Profetësia dhe Allahu zgjedh

nga robtë e Tij ata që janë më punëmirët dhe më merituesit.

Ebu Dherri kishte dëgjuar që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kishte thënë Aliut: “Ti je te unë, ashtu si ishte Haruni te Musai, por pas meje nuk ka profet”.

E dëgjoi Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur u tha myslimanëve në Gadir Khum, kur u kthye nga Haxhi i Lamtumirës: “Për atë që kam qenë udhëheqës, Aliu është udhëheqësi i tij. O Zot! Duaje cilindo që e do atë (Aliun) dhe bëhu armik për këdo që bëhet armik i tij (Aliut). Përkrahe cilindo që e përkrah atë

dhe poshtëroje cilindo që e poshtëron atë (Aliun)!".

Gjithashtu, ka dëgjuar prej Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Aliu është me të drejtën dhe e drejta është me Aliun!”

Fatkeqësisht, disa myslimanë u hoqën sikur i kishin harruar këto hadithe.

PAS PROFETIT MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vdiq dhe gjatë kohës që djali i xhaxhait të tij dhe zëvendësi i tij, Ali ibn ebu Talibi, po mundohej të kryente ritualet e përcjelljes, disa sahabë u grumbulluan në Sakifen beni Saidah dhe Ebu Bekri u bë udhëheqës (kalif).

Shumë sahabë e kundërshtuan këtë veprim. Një prej tyre ishte edhe Selman Farisiu, për të cilin Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Selmani është prej nesh, prej Ehli Bejtit”.

Të tjerë që kundërshtuan këtë veprim të Ebu Bekrit, ishin: Ubadetu ibn Es Sami, Ebu Hejthem et Tejani, Hudhejfetu, Amar ibn Jasiri. Gjithashtu, këtë veprim e kundërshtoi edhe Zonja e grave të botëve, Fatime Zehraja, e cila ishte e zemëruar nga kjo sjellje.

Pas disa muajsh, Imam Aliu, për të mbrojtur interesat e Islamit, i detyruar, ia dha besën Ebu Bekrit. Pasi Imam Aliu e

dha besën, edhe të tjerë ndoqën shembullin e tij, e dhanë besën. Midis tyre ishte edhe Ebu Dherri.

Ebu Dherri mendonte vetëm për interesat e Islamit dhe të myslimanëve. Për këtë ai shkonte në fushëbeteja, për të mbrojtur shtetin islam. Romakët në atë kohë kryenin sulme ushtarake dhe agresione në kufi. Ebu Dherri, me shumë sahabë, doli të luftonte në rrugën e Allahut.

Kalifi i parë, Ebu Bekri, vdiq. Pas tij erdhi Omer ibn Katabi. Në atë kohë Ebu Dherri, së bashku me vëllezërit e tij myslimanë, ishte në luftë, në Sham (Damasku i sotëm).

Vdiq edhe kalifi i dytë, Omer ibn Katabi. Pas tij erdhi Uthman ibn Afani.

Kalifi i tretë nuk ndoqi as jetëshkrimin e Profetit e as të dy sahabëve, Ebu Bekrit dhe Omerit. Ai solli të afërmit e tij dhe i caktoi në poste e pushtete dhe ua mbushi atyre xhepat me paratë e myslimanëve. I dha post në shtet Merua ibn Hakemit, të cilin Profeti Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e dëboi.

Njerëzit ankoheshin nga politika e Othmanit. Një delegacion nga Kufja shkoi te kalifi dhe i thanë se mëkëmbësi i Medines pi alkool, shkon i dehur në xhami dhe vjell në vendfalje (mihrab). Kalifi nuk

bëri asgjë. Përkundrazi Meruani e ofendoi dhe e përzuri delegacionin. Në atë delegacion kishte edhe sahabë.

Ebu Dherri ishte prej këshilluesve të Othmanit. Një ditë i tha atij: “Ndiq sunetin e dy shokëve të tu dhe askush nuk do të flasë keq për ty”. Por Othmani e ofendoi Ebu Dherrin dhe u tha të pranishmëve: “Jepni mendimin tuaj për këtë plak gënjeshtar. A ta rrah, ta burgos, ta vras apo ta dëboj nga toka islame?”

Jo vetëm Ebu Dherri u lëndua shumë nga ky veprim, por edhe myslimanët. Atyre iu kujtua hadithi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili kishte thënë për Ebu

Dherrin: “As në qiell e as në tokë nuk ka si Ebu Dherrri!” Ky kalif e akuzon, duke i thënë se është gënjeshtar.

Ebu Dherrri u largua i mërzhitur nga tubimi i kalifit.

PËR NË SHAM

Kalifi i tretë vendosi që Ebu Dherrin ta dëbonte në Sham. Kur Ebu Dherri mbërriti në Sham, Muavija e urdhëroi mëkëmbësin e Shamit ta dëbojë Ebu Dherrin në vendin që sot quhet Xhebel Amil, në jug të Libanit.

Atje Ebu Dherri filloi t'u mësojë njerëzve hadithet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe jetën e tij. Ai

kundërshtonte devijimin e pushtetarëve, padrejtësitë e tyre ndaj myslimanëve dhe zengjinllëkun e tyre në kurriz të fukarenjve dhe mjeranëve. Ai u lexonte ajetin 34 të sures “Et Teube: “...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm”.

Të varfrit dhe mjeranët e donin shumë atë.

Muavija deshi ta joshte me para Ebu Dherrin, që të heshte. Ai urdhëroi që Ebu Dherrin ta sillnin në Sham dhe i dërgoi atij dhurata të shumta monetare. Ebu Dherri ua shpërndau ato nevojtarëve. Ai kalonte pranë pallatit të Muavijës dhe thoshte: “O

Allah! Mallkoji urdhëruesit në të mirë¹ dhe ata që e kanë braktisur atë. O Allah! Mallkoi ndaluesit nga e keqja² dhe vepruesit e saj!”

Muavija urdhëroi ta arrestonin Ebu Dherrin dhe ta çonin te ai. Ushtarët e arrestuan dhe e çuan të lidhur me zinxhirë te Muavija, i cili i tha me urrejtje të madhe: “O armik i Allahut! Çdo ditë vjen te pallati ynë dhe bërtet me zë të lartë. Unë do të marr leje nga prijësi i besimtarëve, Othmani, për vrasjen tënde!”

¹ Fjala është për Muaviun dhe mbështetësit e tij.
(shënim i përkthyesit)

² Fjala është për Muaviun dhe mbështetësit e tij.
(shënim i përkthyesit)

Më pas Muavija u tha rojeve:
“Merreni dhe burgoseni!”

Muavija i shkroi kalifit dhe e lajmëroi për veprimet që bënte Ebu Dherri dhe njerëzit mblidheshin rreth tij. Kalifi e urdhëroi Muavijën, që të vepronte ashpër ndaj Ebu Dherrit dhe ta kthente atë në Medine.

Myslimanët e morën vesh këtë gjë dhe u lënduan shumë. Ata dolën ta përshëndetnin shokun e të Dërguarit të Allahut.

Ebu Dherri i hipi devesë së tij. Atë e shoqëronin rojet zemërgurë, të cilët nuk respektuan as moshën e tij të pleqërisë e as

dobësinë e tij. Kur mbërriti në Medine, Ebu Dherri ishte shumë i lodhur. E çuan para kalifit, por nga lodhja e madhe desh u rrëzua për tokë.

- Mjerë ti o Othman! - i tha ai Othmanit. - A nuk e ke parë Profetin Muhamed?! A është metoda jote e udhëheqjes si metoda e tij? Ti po më trajton mua njësoj si tiranët!

- Largohu nga vendi ynë! - i tha Othmani me ton të ashpër.

- Ku të shkoj? - e pyeti i pikëlluar Ebu Dherri.

- Shko ku të duash.

- A të shkoj në Sham, në tokën e xhihadit?

- Jo. Nuk dua të shkosh në Sham.

- A të shkoj në Irak?

- Jo.

- A të shkoj në Egjipt?

- Jo.

- Po, ku të shkoj? - e pyeti zemërcopëtuar.

- Te beduinët.

- A të shkoj te beduinët?

- Jo, i tha kalifi, madje më larg. Shko në lindjen më të largët, në Rebdhetu.

- Allahu është më i Madhi! (Allahu ekber). I Dërguari i Allahut ka thënë të vërtetën, kur më lajmëroi për këtë.

- Çfarë të tha Profeti?

- Profeti më lajmëroi se unë do të ndalohem të jetoj në Medine dhe në Mekë dhe do të vdes në Rebdhetu. Varrimin tim do ta bëjë një popull nga banorët e Irakut, gjatë rrugën së tyre për në Hixhaz.

Ebu Dherri, së bashku me gruan dhe vajzën e tij, doli nga Medina dhe u nis për më Rebdhetu. Aty atij iu kujtua thënia e Profetit Muhamed: “O Ebu Dherr. Ti do të

për Ebu Dherrin (r.a)

jetosh i vetëm. Do të vdesësh i vetëm. Do të ringjallesh i vetëm dhe do të hysh në Xhenet i vetëm”.

VDEKJA E EBU DHERRIT

Ebu Dherri vdiq në muajin Dhul Hixhe, në vitin 32 hixhri, në kohën e kalifatit të Osman ibn Afanit.

Varri i tij ndodhet në Err Rrebdhetu, që ndodhet 200 kilometra larg Medines së

Ndritshme e rrethuar nga malet e Hixhazit. El Harbi, në librin e tij “El Menasik”, thotë se në Err Rrebdhetu gjendet një xhami me emrin Xhamia e Ebu Dherrit, në të cilën ndodhet varri i tij.

për Ebu Dherrin (r.a)

POROSI TË PROFETIT MUHAMED

(Paqja e bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

PËR EBU DHERRIN

(Allahu goftë i kënaqur me të!)

1- O Ebu Dherr! Adhuroje Allahun sikur ti e sheh Atë. Nëse ti nuk e sheh Atë, pa dyshim që Ai të sheh ty. Dije se adhurimi i parë i Allahut është njohja e Tij. Ai është i Pari, para çdo gjëje dhe asgjë nuk ka para Tij. I vetëm pa të dytë. I Qëndrueshmi pa mbarim. Krijuesi i qiejve dhe i tokës, çfarë ka në to dhe çfarë ka mes tyre. Ai është i Buti, i Mirëinformuari. Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë. Pastaj të më besosh mua dhe të pohosh se Allahu më dërgoi mua përgëzues dhe paralajmërues për mbarë njerëzit dhe thirrës në rrugën e Tij, e me lejen e Tij, edhe pishtar ndriçues. Më pas të ndiesh dashuri për Ehli Bejtin tim, prej të cilëve Allahu

largoi papastërtinë e gjynaheve dhe i pastroi plotësisht.

2- Dije o Ebu Dherr se Allahu i Lartësuar e i Madhëruar e ka bërë Ehli Bejtin në umetin tim si anija e Nuhut. Ai që hipën në të, shpëton dhe ai që e kundërshton atë, mbytet. E ka bërë Ehli Bejtin si porta El Hitatu te bijtë e Izraelit. Kush hyn nga ajo portë, është i sigurt.

3- O Ebu Dherr! Ruaji këto porosi që po të jap, që të jesh i lumtur në këtë jetë (dynja) dhe në Jetën Tjetër (Ahiret)!

4- O Ebu Dherr! Janë dy mirësi, që shumë njerëzve u mungojnë: shëndeti dhe koha e lirë.

5- O Ebu Dherr! Shfrytëzo pesë para pesëve: 1- Rininë para pleqërisë. 2- Shëndetin para sëmundjes. 3- Pasurinë para varfërisë. 4- Kohën tënde të lirë para të punësuarit tënd. 5- Jetën tënde para vdekjes tënde.

6- O Ebu Dherr! Kujdes nga zvarritja e punës tënde, sepse ti je në ditën tënde dhe

jo në atë pas saj. Nëse për ty ka të nesërme, atëherë bëhu të nesërmen, ashtu siç je në ditën e sotme. Nëse nuk ka të nesërme, nuk do të pendohesh për të këqijat e të sotmes.

7- O Ebu Dherr! Sa njerëz e pritën ditën dhe nuk e mbyllën atë dhe sa pritës të ditës së nesërme, nuk e arritën dot atë.

8- O Ebu Dherr! Sikur të shihje exhelin dhe rrugëtimin (mesijrehu) e tij, do të urreje shpresën dhe mashtrimin e tij.

9- O Ebu Dherr! Ji në dynja sikur i huaji apo rrugëtari dhe llogarite veten tënde prej banorëve të varreve.

10- O Ebu Dherr! Nëse zgjohesh, mos i flit vetes tënde për darkën. Nëse ngrysesh, mos i flit vetes tënde për sabahun. Ruaje shëndetin tënd para sëmundjes tënde, jetën tënde para vdekjes tënde. Ti nuk e di se si do të jetë emri yt nesër.

11- O Ebu Dherr! Kujdes që vdekja, të mos të të kapë, kur je duke gabuar, pasi as gabimet nuk falen dhe as nuk ka kthim; as

nuk do të lavdërohesh për atë që ke lënë e as puna që ke bërë, nuk të justifikon e nuk të shfajëson.

12- O Ebu Dherr! Bëhu ruajtës i jetës tënde më shumë se sa ruajtës i dirhemit dhe dinarit tënd.

13- O Ebu Dherr! A pret dikush nga ju, tjetër gjë përveç të pasurin e padrejtë apo të varfrin e harruar, apo të sëmurin e shkatërruar, apo plakun e ulur, apo vdekjen e përgatitur, apo dexhalin? Ajo është më e keqja që pritet. Apo pret kohën

e ringjalljes, që është më e keqja dhe më e hidhura?! Njeriu me pozitë më të keqe te Allahu, në Ditën e Kiametit, është dijetari që nuk sjell dobi me dijen e tij.

14- O Ebu Dherr! Kush kërkon dijen, që me atë të mashtrojë njerëzit, ai nuk nuhat aromën e Xhenetit.

15- O Ebu Dherr! Nëse pyetesh për një dije që nuk e di, thuaj: “nuk e di”, që të shpëtosh prej pasojave të saj (pyetjes). Mos jep mendim për atë që nuk e di, që të shpëtofsth nga dënimi i Allahut në Ditën e Kiametit. Kushdo që kërkon dituri, për t’i

kthyer fytyrat e njerëzve kah ai, nuk do ta nuhasë erën e Xhenetit.

16- O Ebu Dherr! Disa banorë të Xhenetit do të vështrojnë disa banorë të Xhehenemit dhe do të thonë: “Çfarë ju çoi juve në zjarr, kurse ne hymë në Xhenet?!” Ata do të përgjigjen: “Ne urdhëronim për të mirë, por nuk e vepronim atë”.

17- O Ebu Dherr! Të drejtat e Allahut të Lartësuar e të Lavdëruar ndaj robëve janë më madhështore, kur ata i zbatojnë ato. Mirësitë e Allahut janë më të shumta,

se sa kur njerëzit i numërojnë. Por ju ngrysunë dhe gdhihuni të penduar.

18- O Ebu Dherr! Gjatë kalimit të natës e ditës, ty të pakësohet mosha, të ruhen punët dhe vdekja të vjen papritur. Kush mbjell të mirën, do të korrë mirësi e, kush mbjell të keqen, do të korrë pendim. Çdo mbjellës do të ketë korrje të njëjtë me atë që mbjell. Ngadalësia nuk e paraprin çastin e as lakmitari nuk e arrin atë që nuk i është caktuar. Atij që i është dhënë e mira, Allahu ia ka dhënë dhe ai që është i mbrojtur nga e keqja, Allahu e ka mbrojtur.

19- O Ebu Dherr! Të devotshmit janë zotërinj, fakihët (juristët islamë) janë udhëheqës dhe shoqërimi me ta është bereqet. Besimtari e sheh gjynahun e tij, sikur të jetë një shkëmb që bie mbi të, ndërsa jobesimtari e shikon gjynahun e tij si një mizë që kalon para hundës së tij.

20- O Ebu Dherr! Allahu i Madhëruar e i Lartësuar, nëse i dëshiron mirësi një robi, ia vendos gjynahet e tij para syve të vet e, nëse ia do të keqen, bën që ai t'i harrojë ato.

21- O Ebu Dherr! Mos shiko vogëlsinë e gjynahut, por shiko se ndaj kujt e bën gjynahun.

22- O Ebu Dherr! Në përballjen me gjynahun, besimtari është më i shpejtë se sa zogu që fluturon në folenë e tij.

23- O Ebu Dherr! Atij që i përputhen veprat me fjalët, është fatlum. Atij që fjalët nuk i përputhen me veprat, është qortues i vetvetes.

24- O Ebu Dherr! Njeriu privohet nga risku i tij për shkak të gjynahut që bën.

25- O Ebu Dherr! Mos u hiq ai që nuk je! Mos thuaj atë që nuk të takon! Ruaje gjuhën tënde, ashtu siç ruan paranë!

26- O Ebu Dherr! Allahu i Lartësuar e i Lavdëruar do ta fusë një popull në Xhenet dhe do t'i japë atij shumë të mira. Mbi ta do të jetë një popull në shkallë më të lartë. Kur t'i shohin, do t'i njohin dhe do të thonë: "O Zoti ynë! Këta ishin vëllezërit tanë në dynja. Me çfarë i bëre ata më parësor?" Do

t'u thuhet: Ata qëndronin të uritur, ndërkohë që ju ngopeshit. Qëndronin të etur, ndërkohë që ju e shuanit etjen. Çoheshin natën për namaz, ndërkohë që ju flinit, ata drejtoheshin nga qielli ndërkohë që ju mbanit kokat e ulura.

27- O Ebu Dherr! Allahu i Lartësuar e i Lavdëruar e ka vendosur kënaqësinë time te namazi dhe e ka bërë atë të dashur për mua, ashtu siç e ka bërë të dashur ushqimin për të uriturin dhe ujin për të eturin. Kur i urituri ha, ngopet dhe, kur i eturi pi, e shuan etjen, kurse unë nuk ngopem me namazin.

28- O Ebu Dherr! Kushdo që fal vullnetarisht dymbëdhjetë rekate, përveç namazeve të detyruara, ka të drejtë të ketë një shtëpi në Xhenet.

29- O Ebu Dherr! Për sa kohë je në namaz, ti troket në portën e Sunduesit të fuqishëm. Kush e shton trokitjen e portës, Sunduesi ia hap atij.

30- O Ebu Dherr! Cilido besimtar që është në namaz, mbi të shpërndahen mirësitë mes tij dhe Arshit (Fronit) dhe për atë është caktuar një engjëll që thotë: “O i

biri i Ademit! Sikur ta dish se çfarë mirësish gjenden për ty në namaz dhe cilit i thërret, nuk do largoheshe nga namazi.

31- O Ebu Dherr! Lum flamurbajtësit në Ditën e Kiametit, të cilët do t'i bartin ata dhe do t'u paraprijnë njerëzve për në Xhenet. Ata janë të parët që shkojnë në xhami jo vetëm në syfy.

32- O Ebu Dherr! Namazi është shtylla e fesë dhe gjuha më e madhe; sadakaja fshin gabimet (gjynahet); agjërimi është mbrojtja nga zjarri; xhihadi është nder, krenari.

33- O Ebu Dherr! Hapësira e shkallëve në Xhenet është si hapësira mes qiellit dhe tokës. Robi do të ngrejë sytë e do t'i shndrisë një dritë, e cila gati sa nuk ia merr shikimin. Ai do të trembet e do të thotë: "Çfarë është kjo?" Atij do t'i thuhet: "Kjo është drita e vëllait tënd". Ai do të thotë: "Vëllai im, filani, që punonim së bashku në dynja dhe ai është favorizuar kështu ndaj meje". Atij i thuhet: "Ai ishte më i mirë se ti në vepra".

34- O Ebu Dherr! Dynjaja është burg për besimtarin dhe parajsë për

jobesimtarin e besimtari zgjohet i
bregosur në të.

35- O Ebu Dherr! Ai që ka mundësi të qajë, le të qajë. Ai që nuk mund të qajë, le ta bëjë zemrën e tij ta ndiejë hidhërimin dhe të bëjë sikur qan. Zemra e ashpër është larg Allahut të Lartësuar, por ata nuk e ndiejnë.

36- O Ebu Dherr! Atij që i është dhënë dituria dhe nuk qan prej saj, me të vërtetë, ka marrë një dije jodobiprurëse. Allahu i ka cilësuar kështu dijetarët: **“Besoni në të (Kur’anin) apo nuk besoni, ata që u është dhënë dijenia para (shpalljes së) tij, bien**

në sexhde me fytyrat përtokë, kur ai u lexohet, dhe thonë: ‘Qoftë i lavdëruar Zoti ynë! Me të vërtetë, premtimi i Zotit është plotësuar!’ Ata bien me fytyrë përtokë, duke qarë dhe ai (*leximi i Kuranit*) ua rrit përruljen”. (Sure “Isra”, ajetet 107-109)

37- O Ebu Dherr! E para gjë që largohet nga ky umet, është amaneti dhe frika, deri sa të duket sikur nuk sheh të frikësuar”.

38- O Ebu Dherr! Betohem në Atë që shpirti i Muhamedit është në dorën e Tij. Sikur kjo dynja të kishte vlerë te Allahu sa

krahu i mushkonjës apo i mizës, Ai nuk do t'i jepte të pijë asnjë pikë ujë mohuesit (el kafiru).

39- O Ebu Dherr! Nëse Allahu i Plotfuqishëm dhe i Lartësuar dëshiron të mirën për një rob, Ai do ta bëjë atë të kuptojë fenë, të largohet nga dynjaja dhe t'i shohë të metat e veta.

40- O Ebu Dherr! Njeri i zgjuar (i aftë) është ai që qorton veten e tij dhe punon për atë çka pas vdekjes. Njeriu i paaftë është ai që ndjek egon e tij dhe shpreson te Allahu pa bërë vepra.

41- O Ebu Dherr! E vërteta, e drejta është e rëndë dhe e hidhët, kurse e pavërteta, e kota është e lehtë dhe e ëmbël. Sa e sa qejfe të shkurtra trashëgojnë brengë të gjatë.

42- O Ebu Dherr! Ule zërin në përcjelljen e xhenazeve, në luftë dhe kur lexohet Kur'ani.

43- O Ebu Dherr! Kur të ecësh pas xhenazes, mendja jote të analizojë veprimet që bën. Dije se ti je ndjekës i të vdekurit.

44- O Ebu Dherr! Në fundin e zamanit, do të ketë njerëz që veshin lesh në verë e në dimër dhe mendojnë se në këtë vepër ka mirësi. Mirëpo engjëjt e qiejve e të tokës i mallkojnë ata.

45- O Ebu Dherr! Të devotshmit dhe asketët në dynja janë të dashurit (eulijatë) e vërtetë të Allahut.

46- O Ebu Dherr! Kush dëshiron të jetë njeriu më i nderuar, le t'i frikësohet Allahut.

47- O Ebu Dherr! Ai që nuk interesohet se nga e fiton pasurinë, as Allahu i Madhëruar nuk do të interesohet se nga ku ta fusë në Zjarr.

48- O Ebu Dherr! Çdo fjalë e mirë është sadaka dhe çdo hap për në xhami është sadaka.

49- O Ebu Dherr! Kur vdes besimtari, Toka qan dyzet mëngjese për të.

50- O Ebu Dherr! Allahu nuk shikon pamjen tënde, as pasurinë tënde, as thëniet e tua, por Ai shikon zemrën tënde dhe veprat e tua.

51- O Ebu Dherr! Ai që nuk i ka këto të tria në Ditën e Kiametit, ka humbur.

Çfarë janë ato të tria, nëna dhe babai im, u bëfshin kurban për ty?! – e pyeti Ebu Dherri. Profeti i tha: Devotshmëria, e cila e ndalon të veprojë ato që ka ndaluar Allahu; durimi, me të cilin largon paditurinë e mendjelehtëve dhe moralin e mirë me njerëzit.

52- O Ebu Dherr! Nëse dëshiron të jesh njeriu më i fortë, mbështetu te Allahu. Nëse dëshiron të jesh njeriu më fisnik, kije frikë Allahun. Nëse dëshiron të jesh njeriu më i pasur, atëherë bëhu më i besueshëm në atë që është në dorën e Allahut të Madhëruar, se çfarë ke në dorën tënde.

53- O Ebu Dherr! Bëhu i devotshëm, që të jesh njeriu më adhurues. Feja juaj më e mirë është devotshmëria.

54- O Ebu Dherr! Shtylla (themeli) e fesë është devotshmëria, kurse “koka” e saj është bindja.

55- O Ebu Dherr! Kush i bindet Allahut, e ka përmendur Atë, edhe nëse pakësohet namazi i tij (nafilet), agjërimi i tij (agjërimi i pëlqyeshëm) dhe leximi i Kur’anit nga ai.

56- O Ebu Dherr! Devotshmëria është këtu, devotshmëria është këtu (tregonte kraharorin e tij).

57- O Ebu Dherr! Më i dashuri te Allahu, është ai që e përmend më shumë Atë. Më i nderuari te Allahu, është më i devotshmi juaj. Më i shpëtuari prej dënimit të Allahut, është ai që i frikësohet më shumë Atij.

58- O Ebu Dherr! Allahu i Madhëruar e i Lartësuar e frymëzoi vëllanë tim, Isain: “O Isa. Mos e duaj dynjanë, sepse as Unë nuk e dua atë. Dua Ahiretin, sepse ai është vendbanimi i premtuar”.

59- O Ebu Dherr! Ai që bëhet asket në këtë jetë (dynja), Allahu ia forcon urtësinë në zemrën e tij, me të flet gjuha e tij, me të e bëri të shohë të metat e dynjasë, sëmundjen dhe ilaçin e saj dhe e nxjerr atë prej saj të shëndetshëm për në vendbanimin e paqes.

60- O Ebu Dherr! Prodhimi i Ahiretit është puna e mirë. Të mbjellat e dynjasë janë pasuria dhe fëmija.

61- O Ebu Dherr! Të lumtur janë asketët në dynja dhe dëshiruesit e Ahiretit, të cilët, tokën e Allahut e bënë qilim, dheun

shtrat, ujin parfum. Librin e Allahut motivim, lutjen e Tij mbulesë dhe dynjanë e copëtojnë copa-copa.

62- O Ebu Dherr! Në çdo gjë mbart nijetin e mirë, madje edhe në gjumë e në ushqim.

63- O Ebu Dherr! Kije frikë Allahun dhe mos iu shfaq njerëzve sikur ti i frikësohesh Allahut, që ata të të nderojnë, ndërkohë që zemra jote është e prishur.

64- O Ebu Dherr! Nëse e sheh vëllanë tënd të përmbahet nga kjo botë, dëgjoje me vëmendje atë, sepse ai të mëson urtësinë. O i Dërguari i Allahut, kush është më i përmbajturi nga njerëzit? – e pyeta unë. Profeti Tha: Ai që nuk i harron varrezat dhe i braktis hijeshitë e dynjasë; interesohet më shumë për atë që është e qëndrueshme (Jetën Tjetër); të nesërmen nuk e llogarit prej ditëve të tij por e llogarit veten ndër të vdekurit.

65- O Ebu Dherr! Ki turp nga Allahu. Betohem në Atë që shpirti im është në dorën e Tij, se unë, kur shkoj për të kryer

nevojën, mbulohem me rrobe, sepse kam turp nga dy engjëjt që janë me mua.

66- O Ebu Dherr! Llogarite veten tënde, para se të japësh llogari, sepse kjo është lehtësi për llogarinë tënde nesër. Peshoje veten tënde, para se të peshohesh. Përgatitu për paraqitjen më të madhe në Ditën që do të paraqitet gjithçka, pasi asgjë e jotja nuk është e fshehur për Allahun.

67- O Ebu Dherr! A dëshiron të hysh në Xhenet?

- Po, - i thashë.

- Shkurto shpresën, vendose vdekjen para syve të tu, ki turp nga Allahu.

- O i Dërguari i Allahut! Të gjithë kemi turp nga Allahu.

- Nuk është ai lloj turpi, por turpi nga Allahu është që të mos harrosh varrezat, të ruash të brendshmen dhe ato që përfshin dhe ruaj kokën dhe atë çfarë përmban. Kushdo që dëshiron dinjitetin e Ahiretit, le t'i lërë stolitë e kësaj bote. Nëse je i tillë, e ke arritur vilajetin e Allahut.

68- O Ebu Dherr! Kur drita hyn në zemër, ajo zgjerohet.

- Cila është shenja e kësaj, t'u bëfshin kurban nëna ime dhe babai im?

- Kthimi te vendbanimi i përjetshëm (të interesuarit për Ahiretin) dhe mosinteresimi për vendbanimin mashtrues (dynjanë) dhe përgatitja për vdekjen, para se të vijë.

69- O Ebu Dherr! Kushdo që vendos ballin e tij (fal namazin) në një tokë, ajo do të dëshmojë për të në Ditën e Kiametit. Në çdo banesë që shkojnë njerëz, ajo ose i bekon, ose i mallkon ata.

70- O Ebu Dherr! Ai që përmend Allahun në mesin e të shkujdesurve, është si luftëtari te ikësit (nga lufta).

71- O Ebu Dherr! Kushdo që braktis dynjanë dhe e kalon ririnë e tij në bindje ndaj Allahut, Allahu do t'i japë atij shpërblimin e shtatëdhjetë e dy të vërtetëve.

72- O Ebu Dherr! Shoqërimi me shokun punëmirë është më i mirë se vetmia; vetmia është më e mirë se shoqërimi me shokun e keq. Diktimi i të

mirës është më i mirë se heshtja dhe heshtja është më e mirë se diktimi i të keqes.

73- O Ebu Dherr! Shoqërohu vetëm me besimtarin. Ushqimin tënd ta hajë vetëm i devotshmi! Mos e ha ushqimin e të shthururve!

74- O Ebu Dherr! Jepja ushqimin tënd atij që e do për hir të Allahut dhe ha nga ushqimi i atij që të do ty për hir të Allahut.

75- O Ebu Dherr! Allahu është në gjuhën e çdo folësi, prandaj frikësohu dhe kupto se çfarë flet.

76- O Ebu Dherr! Braktise kureshtjen e të folurit. Ty të mjafton të flasësh atë që plotëson nevojën tënde.

77- O Ebu Dherr! Kur njeriu flet për gjithçka që dëgjon, ai do të gënjejë.

78- O Ebu Dherr! Asgjë përveç gjuhës nuk e meriton të burgoset më gjatë.

79- O Ebu Dherr! Një prej formave të madhërimit të Allahut të Lartësuar është nderimi i të moshuarit mysliman, nderimi i mbartësve veprues të Kur'anit dhe nderimi i udhëheqësit të drejtë.

80- O Ebu Dherr! Nuk ka punuar ai që nuk ruan gjuhën e tij.

81- O Ebu Dherr! Mos ji shpifës, as lavdërues, as i pabesë e as abuziv.

82- O Ebu Dherr! Njeriu e shton largimin nga Allahu, gjatë kohës që sillet keq me krijesat e Tij.

83- O Ebu Dherr! Ai që lutet pa vepruar, është njësoj si ai që gjuan shigjeta pa hark.

84- O Ebu Dherr! Mjerë për atë që bisedon dhe gënjen që të qeshin njerëzit. Mjerë për atë, mjerë për atë, mjerë për atë!

85- O Ebu Dherr! Kush hesht, shpëton. Thuaje të vërtetën dhe kurrë mos nxirr nga goja jote gënjeshtër.

- O i Dërguari i Allahut! - i fola. - Cili është pendimi i atij njeriu që gënjen me qëllim?

- Kërkimi i faljes dhe pesë kohët e namazit janë pastrues të tij.

86- O Ebu Dherr! Ai që ruan atë që ka ndërmjet kofshëve (organet intime) dhe atë mes nofullave të tij (gjuhën), do të hyjë në Xhenet.

- O i Dërguari i Allahut, a do të dënohemi për ato që shqiptojnë gjuhët tona?

- O Ebu Dherr! Njerëzit do të hidhen me hundë në Xhehenem prej asaj që korrin gjuhët e tyre. Ti do të jesh mirë, nëse hesht. Nëse flet, Allahu do ta shënojë atë që thua, ose për ty, ose kundër teje.

87- O Ebu Dherr! Ruhu nga përgojimi, sepse përgojimi është më i ashpër se kurvëria (zinaja).

- O i Dërguari i Allahut, nëna ime dhe babai im t'u bëfshin kurban! Përse është kjo?

- Kur njeriu që bën zina, pendohet, Allahu ia pranon pendimin, kurse përgojimi nuk falet, deri sa i përgojuari ta falë përgojuesin.

88- O Ebu Dherr! Sharja e besimtarit është shthurje; vrasja e tij është mohim (kufër); ngrënia e mishit të tij (përgojimi i tij) është mosbindje ndaj Allahut dhe shenjtëria e pasurisë së tij është si shenjtëria e gjakut të tij.

- O i Dërguari i Allahut, çfarë është përgojimi?

- T'i përmendësh vëllai tënd atë që nuk i pëlqen.

- O i Dërguari i Allahut, nëse ajo që i përmendet, gjendet te ai?

- Dije se, nëse ia përmend atij atë që është në të, e ke përgojuar e, nëse ia përmend atij atë që nuk është në të, ke shpifur ndaj tij.

89- O Ebu Dherr! Ai që është dygjuhësh dhe dyfytyrësh në dynja, do të jetë dygjuhësh në zjarr.

90. O Ebu Dherr! Thashethemexhiu nuk gjen qetësi prej dënimit të Allahut në Jetën Tjetër (Ahiret).

91- O Ebu Dherr! Thashethemexhiu nuk hyn në Xhenet.

92- O Ebu Dherr! Katër gjëra janë për besimtarin: heshtja, që është adhurimi i parë; thjeshtësia ndaj Allahut të Madhëruar; përmendja e Allahut të Madhëruar në çdo situatë dhe pasuria e paktë.

93- O Ebu Dherr! Shumica e njerëzve që hyjnë në zjarr, janë mendjemëdhenj. Një njeri tha: “A shpëton dikush nga mendjemadhësia, o i Dërguar i Allahut?”

- Po. Shpëton ai që vesh lesh, ai që i hipën gomarit, ai që mjel delet dhe ai që ulet me të varfrit.

95- O Ebu Dherr! Kushdo që mbron vëllain e tij mysliman nga përgojimi, është e drejtë e Allahut që ta çlirojë atë nga Zjarri (Xhehenemi).

96- O Ebu Dherr! Nëse në praninë e dikujt përgojohet vëllai i tij mysliman dhe ai ka mundësi ta mbrojë atë dhe e mbron, Allahu do ta mbrojë atë në dynja dhe në Ahiret. Nëse poshtërohet dhe ai ka mundësi ta mbrojë dhe nuk e mbron, Allahu do ta poshtërojë atë në dynja dhe në Ahiret.

97- O Ebu Dherr! Për sa kohë je i ulur në xhami, për çdo frymëmarrje që merr, Allahu i Madhëruar do të të japë një shkallë në Xhenet, engjëjt luten për ty dhe për çdo frymë që merr, ty të shkruhen dhjetë të mira dhe të fshihen dhjetë të këqija.

98- O Ebu Dherr! Allahu i Madhëruar e i Lartësuar thotë: “Njerëzit më të dashur tek Unë janë ata që e duan njëri-tjetrin për hirin Tim, zemrat e të cilëve janë të lidhura me xhamitë dhe ata që kërkojnë falje në syfyr.

99- O Ebu Dherr! Sikur biri i Ademit të ikte nga furnizimi i tij, ashtu siç ikën nga vdekja, furnizimi do ta kapë atë ashtu siç e kap vdekja.

për Ebu Dherrin (r.a)

100- O Ebu Dherr! Kush ka dy
këmisha, le të veshë njëren prej tyre, kurse
vëllai i tij le të veshë tjetrën.

Burimi: Mekarimul Akhlak

اسم الكتاب: وصايا النبي صلى الله عليه وآله لأبي ذر الغفاري

ترجمة سفارش ها: الشيخ ولنت (عباس) مريا

التصحیح الادبی: یریدا کولا

التصحیح اللغوی: ویولسا کارای

الإخراج النهائي: صبریه فزا

الغلاف: صبریه فزا

الناشر: جمعیت نسیم

تیرانا: 2023